UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/871
Datë: 11/10/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës, në bazë të nenit 105 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 6.10.2017 mori këtë:

VENDIM

I. Studentët e Universitetit të Prishtinës të cilët nuk financohen nga fondet publike (me korrespondencë) por që arrijnë rezultate të shkëlqyera në mësim mund t'iu akordohet një vend studimi i cili financohet me fonde publike nga viti i dytë i studimeve ose në vitin vijues të studimit. Studentët të cilët konkurrojnë për të fituar këtë të drejtë duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- T'i këtë dhënë të gjitha provimet e vitit përkatës të studimeve në afatin e shtatorit.
- Të kenë notën mesatare gjatë studimeve tetë e më lartë, përjashtimisht për FSHMN, për Departamentin e Matematikës dhe Fizikës nota mesatare 7.50 e më lartë).
- Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve.

II. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara në pikën I të këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:
- Certifikatën e provimeve të dhëna më notën mesatare gjatë studimeve, dhe
- Dëshminë se gjatë studimeve nuk kanë vit të përsëritur.

III. Dokumentet e kompletuara paraqitën në fakultetet përkatëse.
Fakultetet marrin vendim lidhur më kërkesat e studentëve dhe një kopje të vendimit i'a dërgojnë Administratës Qendrore të Universitetit të Prishtinës.

IV. Statusi i studentit të rregullt të fituar sipas kritereve të përcaktuara në pikën I do të ruhet në bazë të dispozitave të përcaktuara më Statut. Vendimi të shpallet në tabelat e shpalljes në fakultet dhe në ueb-faqen e Universitetit www.uni-pr.edu.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe vlen deri në marrjen e një vendimit tjetër.

Ky vendim i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve dhe sekretarëve të Fakulteteve;
3. Shërbimit për çështje të studentëve në AQ;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së.

Prof. Dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së